

## **Aktiviteti kreditues dhe depozitues për bankat e nivelit të dytë gjatë periudhës maj - dhjetor 2003**

Nga përpunimi i opinioneve të të intervistuarve dhe nga ecuria e indekseve të ndërtuara për treguesit e aktivitetit kreditues dhe depozitues rezultoi se:

### **Aktiviteti kreditues:**

- niveli mesatar i realizimit të planit për kredinë është rreth 92 për qind, duke qëndruar në të njëjtat nivele si në gjashtëmuorin e parë të vitit 2003;
- madhësia e tregut joformal është reduktuar krahasuar me gjashtë muaj më parë;
- rreziku i procesit të kredidhënies konsiderohet të mos ketë ndryshuar si dhe pritet të qëndrojë në të njëjtat nivele edhe për gjashtëmuorin e ardhshëm;
- kriza energjitike mendohet se nuk ka ndikuar në shlyerjen e kredisë, por konsiderohet se ajo ka reduktuar disi kërkesën për kredi të reja;
- preferenca për kreditim sipas llojit të biznesit ka mbetur e pandryshuar; biznesi i mesëm është më i preferuari;
- sipas opinioneve të të intervistuarve, për të ardhmen pritet:
  - rritje e aktivitetit kreditues dhe në veçanti të kredisë për bizneset;
  - rritja e kreditimit në valutë do të jetë më e theksuar se sa e kreditimit në lekë;
  - normat e interesit në lekë dhe në valutë pritet të ulen;
  - sektori i tregtisë do të vazhdojë të jetë sektori më i preferuar për kreditim.

### **Aktiviteti depozitues**

- periudha qershor – dhjetor 2003 është karakterizuar nga një aktivitet depozitues më i mirë krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës;
- diferenca e normave të interesit midis depozitave në lekë dhe në valutë ka favorizuar rritjen e depozitave në lekë ndërsa ka frenuar ritmet e rritjes së depozitave në valutë në këtë periudhë;
- në gjashtëmujorin e ardhshëm aktiviteti depozitues shihet me optimizëm. Specialistët presin rritje të nivelit të depozitave si në lekë ashtu dhe në valutë;
- normat e interesit të depozitave në lekë pritet të vazhdojnë tendencën ulëse ndërsa për normat e interesit në valutë nuk pritet të ketë ndryshime;
- privatizimi i Bankës së Kursimeve nuk do të ndikojë *yield*-in e bonove të thesarit. Ai do të përmirësojë sistemin e pagesave dhe do të rrisë konkurrencën në tregun bankar;
- politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka ndikuar normat e interesit me anë të vendimeve për uljen e normës së repos. Ndërhyrja e saj pohohet e efektshme në rregullimin e deformimeve dhe në rritjen e eficiencës së sistemit bankar.

### **Pritshmëritë për inflacionin:**

- inflacioni parashikohet të qëndrojë në nivele të njëjta me nivelet e periudhës dhjetor 2002 – maj 2003.